



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.142/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afiete Sada-Glllogjani dhe Adnan Konushevcu, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e paraqitur nga BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 02.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet ankesa e organizatës BIRN, me seli në Prishtinë, ndërsa Koalicionit AAK&PSD, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 2,600.00 euro (dy mijë e gjashtëqind), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 30.09.2019, me të cilën pretendon se kandidatja për deputete Donika Kadaj-Bujupi, nga radhët në Koalicionit AAK&PSD, në postimin e saj në rrjetin social Facebook, ka publikuar fotografi nga një tubim i fushatës zgjedhore ku shihet duke bërë fushatë me disa fëmijë me llogo të Koalicionit AAK&PSD. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë kandidatja për deputete Donika Kadaj-Bujupi, Koalicionit AAK&PSD, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur dy fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të Koalicionit AAK&PSD, të datës 01.10.2019, theksuan se ankesa me nr. Anr.142/2019 e datës 30.09.2019 është e pabazuar sepse fotot e publikuara në Facebook kanë të bëjnë me përmbledhjen e një aktiviteti të fushatës zgjedhore ku në fotografinë e parë shihet kandidatja për deputete Donika Kadaj-Bujupi duke bërë fushatë me një fëmijë, i cili nuk është i mitur por i moshës madhore, ndërsa në fotografinë e dytë shifet kandidatja për deputet Donika Kadaj-Bujupi me një nënë dhe një fëmijë, i cili nuk posedon asnjë lloj materiali zgjedhor të Koalicionit AAK&PSD.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtuesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se kandidatja për deputete Donika Kadaj-Bujupi, ka përdorur fëmijë në një tubim për fushatë zgjedhore dhe i ka postuar në rrjetin social Facebook, veprim ky që është në kundërshtim me zgjedhjet e nenin 2 pika 5.3 e Riformular pika b), c) dhe d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019 mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së, që në rastin konkret, në njëërën fotografi shifet një fëmijë nën moshën 18 vjet i cili bartë material promovues në një tubim të fushatës zgjedhore, Paneli ka vlerësuar se nga ana e koalicionit AAK-PSD, është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.13/2013, për *“Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”*, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, pasi që koalicioni në fjalë, me qëllim të promovimit të programit të subjektit të tyre politik, gjatë fushatës zgjedhore, në rrjetin social ka përfshirë fëmijë, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 par. 2, pika h), të rregullës zgjedhore të lartpërmendur, ku ndër të tjera parashihet se: *“Personat të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve përveç kur janë të shoqëruar nga prindërit apo me pëlqimin e prindërve”*

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Faktin se subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se Koalicionit AAK&PSD, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e tyre, nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar, me arsyetimin e tyre se fotografinë e parë të bashkangjitur shihet kandidatja për deputete Donika Kadaj-Bujupi duke bërë fushatë me një fëmijë, i cili nuk është i mitur por i moshës madhore, ndërsa në fotografinë e dytë shifet kandidatja për deputet Donika Kadaj-Bujupi me një nënë dhe një fëmijë, i cili nuk posedon asnjë lloj materiali zgjedhor të Koalicionit AAK&PSD.

PZAP mori parasysh pretendimet e tilla, por se këto pretendime janë të pa qëndrueshme pasi në fotografinë e parë fëmija është nën moshën 18 vjeqare, e i cili mban të veshur bluzë me material propagandistik, ndërsa sa i përket fotografisë së dytë është e vërtetë se fëmija është me prindin e tij dhe se nuk mban veshur apo në dorë material propagandistik. Meqenëse

subjekti në fjalë nuk ka ndërmarr veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me këtë vendim dhe shqiptim të gjobës paneli vlerëson se do të ndikon te subjekti politik që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 142/2019 më datën 02.10.2019

**Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.